

VENDIM
Nr.1393, datë 17.10.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS SË
MESME DHE TË KONVIKTIT, NË QYTETIN E PESHKOPISË, DIBËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës së mesme dhe të konviktit, në qytetin e Peshkopisë, Dibër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Peshkopisë.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 5 500 (pesë mijë e pesëqind) m², tokë truall, e vlerësuar me 5 000 (pesë mijë) lekë m², në shumën e përgjithshme 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 193 500 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Peshkopisë.
5. Vlera totale e shpronësimit, 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit nëntor 2008.
7. Punimet për ndërtimin e shkollës së mesme dhe të konviktit të fillojnë më 1.6.2009 dhe të përfundojnë brenda datës 31.12.2010.
8. Bashkia e Peshkopisë të bëjë likuidimin e pronarit, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS SË MESME DHE KONVIKTIT NË BASHKINË E PESHKOPISË**

Pronari	Z.K	Nr. pas.	Sip.truall	Çmimi truall lek/m²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Asllan Halit Hoxha (Kuçka)	2932	10/27, 10/29	5 500	5 000	27 500 000	27 500 000

Vlera totale e shpronësimit është 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë.